



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:104416

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05516301

C.nr.1692/22

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Shyqri Hoxha, me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.M. me vendbanim në Prizren, të cilin me autorizim e përfaqëson av. A.K. nga Prishtina, kundër të paditurës T.K. në Prishtinë-Dardania, p.n., të cilën me autorizim e përfaqëson S.Th. me objekt të padisë anulimin e vendimi dhe shpërblim dëmi, vlera e kontestit 2,145.15 (dymijë e njëqind e katërdhjetë e pesë euro e pesëmbëdhjetë cent), pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në prezencën e të aturizuarës së palës paditëse dhe përfaqësuesit të të paditurës, me datë 24 janar 2024, mori, ndërsa me datë 28 mars 2024, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit F.M. nga Prizreni me të cilën ka kërkuar që të *“ANULOHET si i kundërligjshëm vendimi nr.01-1286122, i datës 21.04.2022, i Komisionit të Ankesave-Telekomi i Kosovës në Prishtinë TK SH.A., DETYROHET e paditura T.K. në Prishtinë që paditësit të i'a kompensoj pagat e pa paguara për periudhën 25.01.2022 deri me datë 24.07.2022, për muajin janar shumën 66.16 euro, për muajin shkurt shumën 293.67 euro, për muajin mars shumën 293.67 euro, për muajin prill shumën 293.67 euro, për muajin maj shumën 293.67 euro, për muajin qershor shumën 293.67 euro, për muajin korrik shumën 226.03 euro apo shumën 1,760.49 euro, me kamat ligjore prej 8% duke llogaritur nga arritshmëria e secilës kërkesë për pagesë veç e veç, e të cilat janë bërë të arritshme me përfundimin e muajit për secilën pagë, e deri të përmbushja e detyrimit nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë, DETYROHET e paditura që paditësit të paguajë, kontributin*

*pensional të punëdhënsit 25.01.2022 deri me datë 24.07.2022 shumën 102.15 euro dhe kontributin pensional të punëtorit shumën 102.15 euro, **DETYROHET** e paditura që paditësit, të paguajë tatimin në paga për periudhën 25.01.2022 deri me datë 24.07.2022, shumën 180.37 euro, **DETYROHET** e paditura t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës" si e **pa bazuar**.*

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi F.M. me vendbanim në Prizren, përmes të autorizuarës së tij av. A.K. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 24 maj 2022 ka parashtruar padi për anulimin si të kundërligjshëm të vendimit nr.01-12861/22 të datës 21.04.2022, të Komisionit të Ankesave i TK SH.A. dhe kompensimin e dëmit nga marrëdhënia e punës, në të cilën ka theksuar se paditësi ka të themeluar marrëdhënie pune te Posta dhe Telekom i Kosovës në Prishtinë nga viti 2009 dhe vazhduar sipas kontratës së punës me afat të pacaktuar me Nr.01-5182-600/14, datë 31.12.2014, në pozitën e punës zyrtarë i shitjes dhe kujdesit ndaj konsumatorëve në Prizren dhe sipas nenit 5 të kësaj kontrate i caktohet paga bazë në lartësi të gradës 5. Në vazhdim ka theksuar se me vendimin e Komisionit Disiplinor i Shkallës së Parë numër 04/1/222/22, i datës 17.03.2022, paditësi i është ndërprer marrëdhënia e punës duke mos theksuar dhe bazuar në asnjë dispozitë ligjore dhe cilën shkelje të supozuar ka kryer paditësi. Kundër vendimit të Komisionit Disiplinor i Shkallës së Parë numër 04/1/222/22, i datës 17.03.2022, paditësi ka paraqitur ankesë me pretendimet se me asnjë provë të vetme që z.M. të ketë kryer veprën penale ashtu siç është konstatuar nga komisioni disiplinor për të ia ndërprerë marrëdhënien e punës. Për më tepër komisioni disiplinor në arsyetimin e vendimit, kishte konstatuar se deri te ndërprerja e marrëdhënies së punës ka ardhur për shkak se punonjësi ka shkelur kodin e mirësjelljes duke mos e mbështetur vendimin se në cilën shkelje dhe cilën dispozitë të kodit të mirësjelljes ta ketë shkelur ai, por në arsyetim të vendimit ka konstatuar se në bazë të provave materiale dhe deklaratave është vërtetuar se z.F.M. i sistemuar në punët dhe detyrat e punës, ka bërë

shkelje të kodit penal gjatë kryerjes së detyrës zyrtare duke keqpërdorur krijimin e numrave/shitur/ose bartur të cilat kanë rezultuar sim2sim (nga lista e numrave të shqyrtuara) të cilat janë vërtetuar përmes aplikacionit të CRM. Më tej ka theksuar se me vendimin nr.01-1286122 i datës 21.04.2022, të Komisionit të Ankesave i TK SH.A. është aprovuar pjesërishtë ankesa si e bazuar është anuluar vendimi 04/1/222/22, i datës 13.03.2022, i Komisionit Disiplinor dhe paditësit i është shqiptuar masa disiplinore Suspendim i Përkohshëm nga Puna për periudhën 6 mujore nga data 25.01.2022 deri më datë 24.07.2022. Ka shtuar se në vendim e paditura nuk ka mundur të argumentoj se mbi cilën bazë e mbështet dhe cilën shkelje e ka kryer paditësi sipas legjislacionit në fuqi, baza juridike e rastit Kushtetuta e Kosovës, Ligji për Gjykatat, Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ligji i Punës, Ligji për Procedurën Kontestimore. Në fund ka theksuar se veprimet e punëdhënit paraqesin shkelje të Ligjit të Punës, nenit 70 par.1 nën par.1.6, sepse ligji ka përcaktuar procedurën ligjore, të cilën punëdhënësi do ta ndjek në rastet e ndërprerjes së kontratës së punës nga ana e punëdhënësit, ndërsa në hyrjen, dispozitivin dhe arsyetim të vendimit nuk përshkruhet baza ligjore mbi cilin akt ka kompetenca për të vendos një çështje, për të cilën shkelje disiplinore ka kryer z.Morina, e që kjo shkelje të jetë përcaktuar me ligj ose akt të punëdhënësit, mbi cilat fakte është mbështetur vendimi, për më tepër edhe dëshmitarët të cilët janë dëgjuar nga Komisioni Disiplinor kanë deklaruar se z.M. nuk ka pasur asnjëherë vërejtje dhe ai punon konform instruksioneve dhe njoftimeve të cilat vijnë nga menaxherët e njësive, andaj ka kërkuar që ta aprovohet kërkesëpadia e paditësit, anulohet si i kundërligjshëm vendimi nr.01-1286122, i datës 21.04.2022 i Komisionit të Ankesave i TK SH.A., detyrohet e paditura në emër të dëmit, paditësit t'ia kompensojë në emër të pagave mujore të munguara, si dhe shtesat që i takojnë nga marrëdhënia e punës për çdo muaj duke filluar prej muajit janar të vitit 2022, kur edhe është suspenduar përkohësisht nga marrëdhënia e punës, në xhirrollogarinë e paditësit me kamatë ligjore prej 8% që nga dita e arritjes së kërkesës e deri në përmbushjen e plotë të detyrimit, detyrohet e paditura në emër të dëmit, që paditësit t'ia paguajë dëmin moral të shkaktuar me veprimin e kundërligjshëm nga i padituri me me kamatë ligjore prej 8% që nga koha e paraqitjes së padisë në gjykatë e deri në përmbushjen e plotë të detyrimit, detyrohet e paditura t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën që do ta caktoj gjykata, brenda 15 ditësh ëq nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Më parashtrësën e datës 27

nëntor 2023 e autorizuar e paditësit ka bërë saktësimin e kërkesëpadisë dhe lartësisë së saj, ashtu që tani, ka kërkuar që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit F.M. anulohet si i kundërligjshëm vendimi nr.01-1286122, i datës 21.04.2022, i Komisionit të Ankesave-Telekomi i Kosovës në Prishtinë TK SH.A., detyrohet e paditura Telekomi i Kosovës në Prishtinë që paditësit të i'a kompensoj pagat e pa paguara për periudhën 25.01.2022 deri me datë 24.07.2022, për muajin janar shumën 66.16 euro, për muajin shkurt shumën 293.67 euro, për muajin mars shumën 293.67 euro, për muajin prill shumën 293.67 euro, për muajin maj shumën 293.67 euro, për muajin qershor shumën 293.67 euro, për muajin korrik shumën 226.03 euro apo shumën e përgjithshme 1,760.49 euro, me kamat ligjore prej 8% duke llogaritur nga arritshmëria e secilës kërkesë për pagesë veç e veç, e të cilat janë bërë të arritshme me përfundimin e muajit për secilën pagë, e deri të përmbushja e detyrimit nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë, detyrohet e paditura që paditësit të paguajë, kontributin pensional të punëdhënësit 25.01.2022 deri me datë 24.07.2022 shumën 102.15 euro dhe kontributin pensional të punëtorit shumën 102.15 euro, detyrohet e paditura që paditësit, të paguajë tatimin në paga për periudhën 25.01.2022 deri me datë 24.07.2022, shumën 180.37 euro, detyrohet e paditura t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën që do ta caktoj gjykata, brenda 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

I autorizuari i të paditurës në përgjigjen në padi ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit duke theksuar se është në kundërshtim të plot me nenin 253.1 të LPK-së sepse padia nuk përmban kërkesën në pikëpamje të çështjes kryesore dhe kërkesave aksesore, padia nuk përmban faktet mbi të cilat paditësi e bazon kërkesën, padia nuk përmban provat me të cilat vërtetohen faktet e tilla ashtu që nuk mund të kuptohet se cili është objekti i kontestit. Më tej thekson se vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me nr.04/1/222/22 të datës 17.02.2022 është në harmoni të plotë me kompetencat dhe autorizimet e punëdhënësit-Kryeshefit Ekzekutiv. Ka theksuar po ashtu se vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është në harmoni të plotë me dispozitat e Ligjit të Punës gjegjësisht nenit 70, po ashtu ky vendim është në harmoni të plotë edhe më Kodin e Mirësjelljes së Punonjësve dhe Procedurat Disiplinore nr.01-5799/19 e datës 23.10.2019 gjegjësisht nenin 20 ku përcaktohet masat disiplinore për shkeljet e detyrave të punës.

Në vazhdim ka theksuar se bazuar në raportin për paraqitje në Komisionin Disiplinor-TIK SH.A. nr.04/1-222, të datës 19.01.2022, Komisioni Disiplinor i të paditurës, në shqyrtimin paraprak të datës 13.01.2022 dhe në shqyrtimin kryesor të mbajtur me datë 19.01.2022, duke vendosur lidhur me përgjegjësin disiplinore të punonjësit paditësit F.M. për shkak të shkeljeve të detyrave të punës sipas Kodit të Mirësjelljes së Punonjësve. Më tej ka theksuar se sipas listës së numrave të evidentuar në Crm i njëjti ka shitur numra të valës pa u regjistruar dhe nënshkruar nga pronarët e numrave që nënkupton blerësit e numrave dhe që nuk i ka printuar fare që ishte obligim të vërtetohej dhe të cilat kanë rezultuar sim2sim. Gjithashtu është vërtetuar se punëtori në fjalë me krijimin e këtyre numrave (45 numra) të cilat kanë rezultuar sim2sim ka shkaktuar dëm financiar në buxhetin e TK-së në shumën prej 329.98 euro.

E autorizuar e paditësit av. A.K. në seancën përgatitore edhe përgjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi si në padi dhe precizimin e kërkesëpadisë të dorëzuar në gjykatë me datë 27.11.2023. ndërsa sa i përket ekspertizës ka deklaruar se për të njëjtën nuk ka vërejtje, por vetëm pyetje. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi si në pretendimet në padi, në këtë çështje pas administrimit të provave vërtetohet drejtë gjendja faktike se paditësi është suspenduar përkohësisht nga e paditura me vendimin e padrejtë dhe të pa ligjshëm sepse paditësi nuk ka bërë asnjë shkelje ashtu siç pretendon e paditura se ka kryer vepër penale. Gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovoj si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar të cilat i ka specifikuar dhe atë për përpilimin e padisë 104.00 euro, shumën prej, 135.40 euro për përfaësim në tri seanca gjyqësore, pageën për ekspertizë gjyqësore shumën prej 150 euro dhe për taksë shumën prej 30 euro.

I autorizuari i të paditurës S.Th. në seancën përgatitore edhe përgjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se qëndrojnë pranë përgjigjes në padi të dorëzuar me datë 07.04.2023. E ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe precezimin, po ashtu edhe ekspertizën. Ka konsideruar se padia dhe kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar në fakte dhe prova, po ashtu konsideron se vendimet e Komisionit Disiplinor janë në drejta. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se duke u mbështetur në thëniet në

përgjigjen në padi, si dhe deklarimeve në seancat e kaluara, i ka propozuar gjykatës që pas shqyrtimit të thënieve të kësaj përgjigje dhe administrimit të provave të prezantuara konform nenit 391 par.1 pika g të LPK-së, të nxjerr aktgjykim ku refuzohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit Fadil Morina dhe obligohet paditësi t'i bartë shpenzimet e procedurës.

Provat e administruara

Për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: kontratën së punës me nr.01-5182-600/14, e datës 31.12.2014, vendimin e Komisionit Disiplinor i shkallës së parë me nr.04-1/222/22, i datës 17.03.2022, ankesën të paraqitur nga pala paditëse pranë Komisionit të Ankesave me nr. të prot.01-1286/22, e datës 08.04.2022, vendimin e Komisionit të Ankesave pranë të paditurës me nr.01-1286/22, i datës 21.04.2022, leximin e tetë referencave të lëshuar nga punëdhënësi për paditësin, raportin për paraqitjen në Komisionin Disiplinor me nr. 04/1-222/22, i datës 19.01.2022, procesverbalet e komisionit disiplinor të datës 13.01.2022 dhe procesverbalin e datës 19.01.2022, listën e numrave të nxjerr nga sistemi CRM, leximin e vendimit nr.04/3709/21, i datës 05.11.2021, leximin e vendimit të Komisionit të Ankesave me nr.01-314/22, i datës 22.02.2022, ankesën kundër vendimit disiplinor të datës 24.01.2022, me nr. të prot. 01-314/22, ekspertizën financiare të përpiluar nga ekspertja S.F. e datës 04.10.2023, ka bërë dëgjimin e ekspertes financiare S.F. në shqyrtimin kryesor të datës 27.11.2023. Gjykata nuk i ka administruar si prova e-mailat ndërmjet paditësit dhe punëdhënësit, për arsye se e autorizuara e paditësit në shqyrtimin kryesor të datës 24.01.2024 është tërhequr nga administrimi i këtyre provave.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është **e pa bazuar**.

Nga leximi i kontratës së punës me nr.01-5182-600/14, e datës 31.12.2014, gjykata ka vërtetuar faktin se pala paditëse ka lidhur kontratë pune me palën e paditur për kohë të pacaktuar, i cili do të kryej këtë detyrë të punës Zyrtar i Shitjes dhe Kujdes ndaj Konsumatorëve, me lokacion në Prizren.

Nga vendimi i Komisionit Disiplinor të shkallës së parë i TK SH.A. me nr. 04/1/222/22, i datës 17.03.2022, gjykata ka vërtetuar se paditësit F.M. i sistemuar në punët dhe detyrat e punës zyrtar i shitjes pranë të paditurës, i është shqiptuar masa disiplinore Ndërprerje e marrëdhënies së punës, për shkak të moszbatimit të instruksioneve, që bie në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes së Punonjësve dhe Procedurave Disiplinore ka bërë shkelje disiplinore dhe ndaj tij ka filluar procedura disiplinore, me rekomandim që nga departamenti ligjor të inicohet më tutje rasti i punëtorit F.M. konform shkeljeve të bëra.

Nga leximi i ankesës me nr. të prot.01-1286/22, të datës 08.04.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka parashtruar ankesë kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të shkallës së parë të TK, SH.A. me numër 04/1/222/22 të datës 17.03.2022, duke e drejtuar ankesën ndaj Komisionit për Ankesa në Telekomin e Kosovës, pranë të paditurës, ashtu siç është udhëzuar nga ana e Komisionit Disiplinor të TK SH.A. në vendimin e lartcekur, duke e kundërshtuar vendimin për arsyet si në vijim shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës së Kosovës, aplikimit të gabuar të së drejtës material, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.

Nga leximi i vendimit të Komisionit të Ankesave pranë TK SH.A. me nr. të prot.01-1286/22, i datës 21.04.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se është aprovuar pjesërisht si e bazuar ankesa e paditësit, është anuluar vendimi i Komisionit Disiplinor me nr.04/1/222/22, i datës 17.03.2022 për të punësuarin F.M. dhe të njëjtit i është shqiptuar masa disiplinore Suspendim i Përkohshëm nga Puna, për periudhën 6 mujore (nga data 25.01.2022 deri me datën 24.07.2022), dhe është obliguar departamenti për punët e Korporatës/Ligjore të vlerësoj mundësin e inicimit të procedurës penale ndaj të punësuarit Fadil Morina.

Nga leximi i tetë referencave, gjykata ka vërtetuar faktin për fjalët të cilat i ka shënuar punëdhënësi dhe kolegët për paditësinë.

Nga leximi i raportit për paraqitje në Komisionin Disiplinor me nr.04/1-222/22, i datës 19.01.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se me rekomandim të Departamentit për Hetime kundër Mashtrimeve është kërkuar që të inicohet masa disiplinore ndaj punëtorit F.M. në Departamentin e Shitjes së TK Regjioni Prizren-pika shitëse Abi Qarshi. Në përputhje me të gjeturat faktike gjatë hetimit të rastit të keqpërdorimit të numrave të krijuar/shitur dhe/ ose bartur të cilët kanë rezultuar Sim2Sim (nga lista e numrave të shqyrtuara) del që nuk janë respektuar në plotësi procedurat e brendshme të T.K.

Nga Procesverbali-Deklaratë nga Komisioni Disiplinor nr.04/1-222/22, i datës 13.01.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se A.K. Udhëheqësi i Pikave të shitjes në Regjionin e Prizrenit ka deklaruar që nga shtatori i vitit 2021, F. është në portal te ai, ata punojnë konform instruksioneve dhe njoftimeve të cilat vijnë nga menaxherët e njëjësive. Më tej ka deklaruar se printer fiskal e kanë por nuk funksionon për arsye se kanë deklaruar se ende nuk ekziston e regjistruar në ARBK. Njoftimi i fundit ka qenë në muajin shtator që nuk është regjistruar ende. Ai e ka njoftuar menaxheren regjionale, ku ajo ka kontaktuar me personat përgjegjës. Po ashtu ka deklaruar se formulari i regjistrimit të numrit printohet në raste, F. nuk i printon gjë që e kanë verifikuar edhe gjatë rastit të inicuar që nuk i kishte printuar formularët e regjistrimit por vetëm i ka proceduar nëpërmes CRM-së. Gjithashtu ka deklaruar se dokumentet e printuara i vendosin në objektin kryesor në Pz, në pikën Abi Qarshia ende nuk janë arkivuar dokumentet për arsye se pika është hapur në mes të qershorit 2021. Po ashtu ka deklaruar se nuk dyshon që dikush ia ka keqpërdorur username F. se në ndërrim nuk punojnë nga dy punëtor, por vetëm një në ndërrim. Në fund ka deklaruar se nuk mendon që F. e ka bërë me qëllim. Këto gabime gjatë regjistrimit janë bërë për shkak të fluksit të madhë të konsumatorëve.

Nga Procesverbali i shqyrtimit përgaditor të lëndës nga Komisioni Disiplinor nr.04/1-222/22, i datës 13.01.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se punëtori F.M. Zyrtar i Shitjes ka deklaruar se asnjëherë nuk ka qenë në komision disiplinor, nuk dyshon që dikush ia ka keqpërdorur sistemin CRM. Ka deklaruar se gjatë datës 17 deri me 20.12.2021 ka

qenë në punë ndërsa nga data 20.12.2021 ka shkuar në pushim vjetor. Më tej ka deklaruar se numra me emra dhe mbiemra të pakuptimtë janë krijuar për shkak të ngarkesës së punës, fluksit të madh dhe nuk ka qenë i vetëdijshëm për krijimin e numrit sim2sim. Në vazhdim ka deklaruar se asnjëherë më parë nuk ka bërë kësi lloji të shkeljes së detyrës zyrtare, ka qenë më parë zyrtar i Telekomit që ka bërë punë dhe detyra për Postën e Kosovës, pastaj ka kaluar si zyrtar i QKK-së. Po ashtu ka deklaruar se nuk i njeh këta persona numrat e të cilëve kanë rezultuar sim2sim, kur një konsumator e kërkon një numër i kërkon dokumentin e identifikimit. Ka deklaruar se të dhënat sipas dokumentit të identifikimit i ka shkruar, por nuk e di pse nuk rezultojnë në sistem të dhënat e sakta. Gjithashtu ka deklaruar se format për shitjen e numrin nuk i printojnë, nuk kanë printer dhe nuk është kërkuar nga ana e tyre që të printohen, pra nga udhëheqësi. Aty ku janë është shumë ngusht dhe nuk ka hapësirë, prandaj ata vetëm e bëjnë raportin final në fund të ndërrimit. Në fund ka deklaruar se konsumatorët vijnë dhe blejnë numra për të gjithë anëtarët e familjes, sidomos të diasporës, pasi që kanë të drejtë që deri në 10 numra të figurojnë në emër të një konsumatori, pazari ditor është rreth 500 euro në ditë dhe se përafërsisht brenda ndërrimit i shet mesatarisht 30 deri 40 numra. Kur ka shumë konsumator ka deklaruar se nuk ks kërkuar ndihmë nga udhëheqësit.

Nga Procesverbali i shqyrtimit kryesor të lëndës nga Komisioni Disiplinor nr.04/1-222/22, i datës 19.01.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se punëtori F.M. Zyrtar i Shitjes ka deklaruar asnjëherë nuk ka qenë, vetëm ka kaluar andej. Po ashtu ka deklaruar se kur ka punuar si staf i TK-së në PK formularët i ka shtypur, nënshkruar, vulosur dhe i kanë dorëzuar te kontrollori. Në rast se nuk i ke dorëzuar nuk kanë pasur mundësi ta përfundojnë ndërrimin.

Nga leximi i listës së numrave të nxjerr nga CRM, gjykata ka vëretuar faktin se disa emra të konsumatorëve janë shënuar gabimisht si dhe numrat personal nuk janë dhjetë shifrore.

Nga leximi i vendimit të Komisionit të Ankesave i TK SH.A. me nr.01-314/22, i datës 22.02.2022, gjykata ka vërtetuar faktin se është refuzuar si e pa bazuar kërkesa për anulimin e vendimit nr.04/1/222/22, të datës 24.01.2022.

Nga leximi i ankesës me nr. të prot.01-314/22, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka parashtruar ankesë kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të shkallës së parë të TK, SH.A. me numër 04/1/222/22 të datës 24.01.2022, duke e drejtuar ankesën ndaj Komisionit për Ankesa në Telekomin e Kosovës, pranë të paditurës, duke e kundërshtuar vendimin për arsyet si të pa pranueshëm dhe në kundërshtim me kontraditat dhe i pa bazuar dhe në kundërshtim me rregulloren dhe Ligjin e Punës. Komisioni Disiplinor në mënyrë të pa drejtë dhe të pa argumentuar ka marr vendim ndaj tij duke e suspenduar përkohsishtë nga puna, në bazë të pikës 2 të vendimit prej 50% të të ardhurave personale deri në vendimin e ardhshëm nga ky komision disiplinor.

Për të vërtetuar lartësinë e pagave të papaguara për paditësin gjykata në cilësinë e provës materiale ka nxjerr ekspertizën financiare, të datës 04.10.2023, të cilën e ka punuar ekspertja financiare S.F. Detyrat e ekspertes janë përcaktuar mbi bazë të vëllimit që ka kërkuar pala propozuese për nxjerrjen e ekspertizës si dhe gjykata dhe detyrë e ekspertes ka qenë që të bëjë llogaritjen e pagave të pa paguara për periudhën nga data 25.01.2022 deri më datë 24.07.2022, si dhe të gjitha shtesave të tjera në punë sipas Ligjit të Punës. Përmes ekspertizës është gjetur se sipas përlllogaritjes për periudhën që kishte ndalesë në pagë nga data 25.01.2022 e deri më 24.07.2022, paga neto është në vlerë prej 1,760.49 euro, kontributi pensional i punëdhënësit 5% është në vlerë prej 102.15 euro, kontributi pensional i punëtorit 5% është në vlerë prej 102.15 euro dhe tatimi në të ardhura personale është në vlerë prej 180.37 euro. Ekspertja llogaritjen e pagës neto, kontributit të punëdhënësit 5%, kontributit të punëmarrësit 5% dhe tatimin mbi të ardhura personale i ka llogaritur përmes mënyrës elektronike që ofron www.atk-ks.org/kalkulatori i pagave, si dhe në bazë të kontratës së punës. Ndërsa për shtesa tjera ka theksuar se nuk ka dëshmi që i takojnë shtesa përpos pagës bruto, bazuar në shkresat e lëndës dhe konfirmimit edhe nga pala e paditur.

Ekspertja financiare S.F. në shqyrtimin kryesor të mbajtur me datën 27.11.2023, ka deklaruar se siç është përshkruar në tabelën nr.3 në kolonën e parë janë të përshkruara muajt për të cilët është diferenca që ka mbetur pa i paguar palës paditëse, tek paga neto janë të përshkruara vlerat që duhet paguar për çdo muaj dhe në fund është totali për kompensim. Më tej ka deklaruar se periudha e llogaritjes është bërë prej datës 25.01.2022, deri me datën 24.07.2022, e cila periudhë përfshinë periudhën e suspendimit të paditësit. Gjithashtu ka deklaruar se sipas kontratës dhe nga konfirmimi nga vet e paditura paga bazë ka qenë në vlerë prej 681 euro, mund të konstatohet se paditësi për këtë periudhë nuk ka pasur shtesa.

Baza Ligjore

Me Ligjin e Punës Nr.03/L-212, i cili ka hyrë në fuqi me datën 16.12.2010, në nenin 78 par.1 është paraparë se *“I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura”*. Në nenin 78 par.2 është paraparë se *“Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës”*. Ndërsa me nenin 79 të të njëjtit ligj është paraparë se *“Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 par.2 i këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të iniciojë kontest pune në Gjykatën Kompetente”*. Po ashtu me nenin 85 par.1 të këtij ligji parashihet se *“Për shkeljen e detyrave të punës, të punësuarit do t'i shqiptohet njëra nga këto masa ndëshkuese: 1.1. vërejtje me gojë; 1.2. vërejtje me shkrim; 1.3. ulje në pozitë; 1.4. suspendim të përkohshëm; 1.5. ndërprerje të marrëdhënies së punës”*. Ndërsa në paragrafin 2 të nenit 85 parashihet se *“Masat ndëshkuese, vërejtje me gojë, vërejtje me shkrim dhe ulje, degradim të pozitës, do të shqiptohen për shkelje të lehta të detyrave të punës në pajtim me Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratën e Punës”*. Ndërsa në paragrafin 3 të nenit 85 parashihet se *“Masat ndëshkuese, suspendimi i përkohshëm dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës, do të shqiptohen për shkelje të rënda të detyrave të punës në pajtim me Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratën e Punës”*. Pastaj, me nenin 86

par. 1 nën par. 1 të LP-së theksohet se *“vendimin për shqiptimin e masave ndëshkuese për shkeljen e detyrave të punës, e nxjerr organi kompetent i punëdhënësit apo punëdhënësi”*.

Me nenin 1 par.1 të Kodit për Mirësjellje të Punonjësve dhe Procedurat Disiplinore me Nr.01-5799/19, i datës 23.10.2019 parashihet që: *“Kodi i Mirësjelljes së Punonjësve dhe Procedurat Disiplinore në ndërmarrjen publike Telekomit I Kosovës Sh.A (me tej TK SH.A.) përcakton rregullat e mirësjelljes të cilat duhet të respektohen nga punonjësit gjatë kryerjes së detyrave dhe ushtrimit të funksionit të tyre”*. Neni 2 par.1 i Kodit të Mirësjelljes së Punonjësve dhe Procedurat Disiplinore parasheh: *“Dispozitat e këtij Kodi janë të detyrueshme për të gjithë punonjësit e Telekomit të Kosovës SH.A”*. Me nenin 16 par.2 të po këtij Kodi parashihet *“shkeljet disiplinore ndahen në dy kategori: 2.1 shkelje të lehta disiplinore dhe 2.2 shkelje të rënda disiplinore”*. Po ashtu me nenin 17 par.1 dhe nenin 18 par.1 të këtij Kodi në mënyrë decitive janë përcaktuar cilat shkelje konsiderohen shkelje të lehta dhe cilat shkelje konsiderohen shkelje të rënda disiplinore. Ndërsa me nenin 20 par.1 të njëjtit Kod parashihet *“për shkeljet e detyrave të punës të përkufizuara me këtë Kod dhe Ligjet në fuqi të punësuarit i shqiptohet njëra nga këto masa disiplinore: 1.1 Vërejtje me gojë; 1.2 vërejtje me shkrim; 1.3 Ulje në pozitë; 1.4 suspendim i përkohshëm nga puna dhe 1.5 ndërprerje e marrëdhënies së punës”*. Neni 20 par.2 i Kodit të Mirësjelljes së Punonjësve dhe Procedurat Disiplinore përcakton *“masat ndëshkuese vërejtje me gojë, vërejtje me shkrim dhe ulje, degradim në pozitë (pagë, ndërrim lokacioni) shqiptohen për shkelje të lehta disiplinore”* Ndërsa në paragrafin 3 të nenit 20 përcaktohet se *“Masat ndëshkuese, suspendim i përkohshëm nga puna dhe ndërprerje e marrëdhënies së punës, shqiptohen për shkelje të rënda të detyrave të punës”*. Po ashtu me nenin 7 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) është paraparë se *“palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Edhe me nenin 319 par.1 të LPK-së përcaktohet që *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*.

Vlerësimi përfundimtarë i gjykatës

Nga provat e shqyrtuara dhe pas analizimit të bazës juridike rezulton se kërkesëpadia e paditësit për anulimin e vendimit me nr.01-1286/22, të datës 21.04.2022, i Komisionit

të Ankesave-Telekomi i Kosovës TK SH.A. është në tërësi e pabazuar. Sepse nga provat e shqyrtuara rezulton se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune te e paditura Telekomi i Kosovës në pozitën zyrtar i shitjes dhe kujdes ndaj konsumatorëve në Regjionin e Prizrenit-pika shitëse në Abi Qarshi. Po ashtu nga provat e lartcekura është vërtetuar se punëdhënësi në këtë rast e paditura masën disiplinore suspendim i përkohshëm nga puna, për periudhën 6 mujore (nga data 25.01.2022 deri më 24.07.2022) sipas vendimit me numër 01-1286/22 datë 21.04.2022, e ka shqiptuar në pajtim me Ligjin e Punës nenin 85 dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit Kodin e Mirësjellsjes së Punonjësve dhe Procedurat Disiplinore nr.01-5799/19, të datës 23.10.2019, pasi që e paditura me rekomandim të departamentit për hetime kundër mashtrimeve ka bërë raportin për paraqitje në komisionin disiplinor me nr.04/1-222/22, i datës 19.01.2022 kundër punonjësit Fadil Morina, është iniciuar procedurë disiplinore për paditësin, më pas është formuar edhe komisioni disiplinor sipas rregullores së referuar për përgjegjësinë disiplinore prej tre anëtarëve që është i balancuar edhe sipas gjinisë po ashtu është mbajtur shqyrtimi përgaditor dhe shqyrtimi kryesor ku i është dhënë mundësia paditësit që të deklarohej për pretendimet për shkelje disiplinore më pas ka pasuar vendimi i Komisionit të shkallës së parë me numër 04/1/222/22. i datës 17.03.2022 me të cilën paditësit i është shqiptuar masa disiplinore ndërprerje e marrëdhënies së punës. Kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të shkallës së parë paditësi ka parashtruar ankesë pranë Komisionit të Ankesave i TK SH.A. e cila me vendimin nr.01-1286/22 të datës 21.04.2022, e ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit e ka anuluar vendimin e Komisionit Disiplinor të shkallës së parë me nr.04/1/222/22, i datës 17.03.2022 dhe të njëjtit i ka shqiptuar masën disiplinore suspendim i përkohshëm nga puna, për periudhën 6 mujore (nga data 25.01.2022 deri më 24.07.2022). Gjykata gjen se përgjegjësia disiplinore e vërtetuar sipas vendimit të Komisionit të Ankesave të punëdhënësit tani të paditurës është e drejtë dhe e bazuar në dispozitat ligjore dhe aktet brendshme të saj, po ashtu gjykata ka gjetur se edhe shqiptimi i masës disiplinore suspendim i përkohshëm nga puna për periudhën 6 mujore është bërë sipas procedurës së përcaktuar ligjore të Ligjit të Punës dhe me Kodin e Mirësjellsjes së Punonjësve dhe Procedurat Disiplinore e të paditurës, po ashtu edhe masa e shqiptuar është proporcionale me nivelin e shkeljes disiplinore pasi që në këtë rast sipas Kodit të Mirësjellsjes së Punonjësve dhe Procedurat Disiplinore nr.01-5799/19 i datës 23.10.2019,

e të paditurës në nenin 17 dhe 18 janë përcaktuar shkeljet e lehta dhe të rënda, ndërsa për shkeljen për të cilën është shpallur përgjegjës paditësi është shkelje e rëndë sipas nenit 18 par.1, pika 1.3, pika 1.6 dhe pika 1.18 të këtij kodi. Përfundimisht gjykata vlerëson se nga provat e administruara është vërtetuar se ka pasur shkelje të rënda të detyrave të punës të konstatuara nga raporti për paraqitje në Komisionin Disiplinor, të cilat shkelje bien në përgjegjësi të paditësit sepse si zyrtar i shitjes në pikën te Abi Qarshia me rastin e shitjes së numrave ka futur të dhëna të pasakta të konsumatorëve në formularët e regjistrimit CRM dhe të njëjtat nuk i ka printuar, e të cilat numra kanë rezultuar sim2sim (numra të keqpërdorur). Pastaj edhe zhvillimi i procedurës disiplinore dhe shqiptimi i masës disiplinore është bërë në pajtim me ligjin e punës dhe aktet e brendshme të paditurës. Gjykata i ka shqyrtuar edhe pretendimet e të autorizuarës së paditësit se paditësi është suspenduar me vendimin e padrejtë dhe të pa ligjshëm sepse paditësi nuk ka bërë asnjë shkelje të Kodit Penal mirëpo gjeti se këto pretendime janë të pa bazuara. Kjo për arsye se këto pretendime më tepër janë të orientuara nga vendimi i Komisionit Disiplinor të Shkallës së parë për shkak se në këtë vendim Komisioni Disiplinor ka bërë aplikimin e gabuar të së drejtës materiale, ndërsa Komisioni i Ankesave i TK SH.A. me vendimin nr.01-1286/22, e datës 21.04.2022 e ka anuluar vendimin e Komisionit Disiplinor të shkallës së parë 04/1/222/22 me të cilën i është shqiptuar masa disiplinore ndërprerje e marrëdhënies së punës të cilën e ka bazuar në shkeljet e dispozitave të Kodit të Mirësjelljes së Punonjësve dhe Procedurat Disiplinore dhe të Kodit Penal dhe paditësit i ka shqiptuar masën disiplinore suspendim i përkohshëm nga puna për periudhën 6 mujore duke u bazuar në dispozitat ligjore të Kodit të Mirësjelljes së Punonjësve dhe Procedurat Disiplinore, andaj kjo shkelje ligjore është evituar nga vetë Komisioni i Ankesave i të paditurës.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse, si dhe prova të tjera, mirëpo vlerësoi se të njëjtat nuk janë relevante dhe janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje juridike.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 450 të LPK-së, pasi që paditësi e ka humbur kontestin ndërsa e paditura nuk i ka specifikuar ato.

Numri i lëndës: 2022:104416

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05516301

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 143 LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1692/22 me datë 28 mars 2024

Gjyqtari

Shyqri Hoxha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.